Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke
Ministry of Education and Science

Datë: 19.10.2026

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), bazuar në nenin 2 të Marrëveshjes së Grantit TF0C3867-XK, të nënshkruar më 28 qershor 2024 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore, si dhe në Vendimin nr. 01B-246, të datës 23.11.2024, shpall:

THIRRJE PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE TË EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME NË PROGRAMIN E KUPONËVE

Programi i Kuponëve synon të përmirësojë qasjen në edukimin në fëmijërinë e hershme për fëmijët nga familjet përfituese të Skemës së Asistencës Sociale (SAS), duke mbështetur mbulimin e shpenzimeve për vijimin e tyre në Institucionet e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (IEFH). Nëpërmjet këtij programi, MASH-i rimburson institucionet pjesëmarrëse për shërbimet e ofruara për fëmijët përfitues, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzuesin e Programit.

Përmes kësaj thirrjeje, MASH-i fton institucionet e interesuara të aplikojnë për pjesëmarrje në program dhe të deklarojnë kapacitetet e tyre të lira për pranimin e fëmijëve përfitues. Thirrja u drejtohet si institucioneve që dëshirojnë të bëhen pjesë e programit për herë të parë, ashtu edhe institucioneve pjesëmarrëse që kanë vende shtesë të lira.

Institucionet që mund të aplikojnë:

Në këtë thirrje mund të aplikojnë institucionet që ofrojnë shërbime të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe janë të licencuara nga MASH. Kategoritë e institucioneve që mund të marrin pjesë në program përfshijnë:

- Institucionet parashkollore private;
- Institucionet parashkollore në partneritet publiko-privat.

Pjesëmarrja në program realizohet përmes aplikimit në platformën e-Kosova dhe verifikimit të përmbushjes së kritereve nga divizioni përgjegjës.

Kriteret për regjistrim në program:

Për t'u regjistruar në Programin e Kuponëve, institucionet aplikuese duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të jenë të licencuara nga MASH për ofrimin e shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme;
- Të kenë së paku një vend të lirë për pranimin e fëmijëve përfitues të programit.

Institucionet duhet të deklarojnë saktë numrin e vendeve të lira që mund të vënë në dispozicion të programit. Këto të dhëna do të shërbejnë për identifikimin e kapaciteteve të disponueshme dhe për procesin e përzgjedhjes dhe regjistrimit të fëmijëve përfitues.

Institucionet pjesëmarrëse do të informohen për përgjegjësitë e tyre lidhur me zbatimin e programit, përfshirë raportimin e vijueshmërisë së fëmijëve dhe dokumentacionin e nevojshëm për rimbursim, sipas Udhëzuesit të Programit.

Shpenzimet që mbulohen nga programi:

Programi i Kuponëve mbështet mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe kur plotësohen kriteret përkatëse, për transportin e fëmijëve përfitues. Rimbursimi i institucioneve bëhet në përputhje me shumat, kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzuesin e Programit.

- Programi rimburson institucionet për shërbimet e ofruara për fëmijët përfitues deri në maksimum 150 euro për fëmijë në muaj. Shuma përkatëse përcaktohet sipas komunës, bazuar në mesataren e çmimeve të raportuara nga IEFH-të gjatë procedurës së licencimit. Kufiri prej 150 eurosh përfaqëson shumën maksimale të rimbursimit dhe jo domosdoshmërisht shumën që përfiton çdo institucion.
- Institucionet që ofrojnë transport mund të rimbursohen për këtë shërbim kur plotësohen kriteret për përfitimin e kuponit të transportit dhe kërkesat për ofrimin e tij, sipas Udhëzuesit. Shuma e rimbursimit përcaktohet nga Komisioni për Vlerësimin e Aplikimeve për Programin e Kuponëve, në varësi të komunës përkatëse dhe distancës rrugore.

Institucionet që ofrojnë transport duhet të sigurojnë përmbushjen e kërkesave të Udhëzuesit për sigurinë e fëmijëve, përshtatshmërinë e automjeteve dhe shoqërimin gjatë udhëtimit.

Procedura e aplikimit

Aplikimi për regjistrim në Programin e Kuponëve, realizohet vetëm përmes platformës e-Kosova, në kategorinë Arsimi, duke përzgjedhur shërbimin "Regjistrimi i institucioneve parashkollore private në Programin e Kuponëve"**.**

Vegëza për aplikim: https://ekosova.rks-gov.net/597

Institucionet e interesuara duhet të plotësojnë formularin elektronik me të dhënat e kërkuara dhe ta dorëzojnë aplikimin brenda afatit të përcaktuar në këtë thirrje. Para dorëzimit, aplikuesit duhet të kontrollojnë saktësinë dhe plotësinë e të dhënave, veçanërisht të informacionit për vendet e lira, shërbimin e transportit dhe llogarinë bankare.

Afati për aplikim:

Thirrja është e hapur për 15 ditë**,** nga 19 tetor 2026 deri më 2 nëntor 2026, përfshirë këtë datë**.** Gjatë kësaj periudhe, institucionet e interesuara duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë aplikimin e tyre në platformën e-Kosova. Institucionet inkurajohen të aplikojnë në kohë dhe të kontrollojnë të dhënat e deklaruara përpara dorëzimit, në mënyrë që aplikimi të jetë i plotë dhe i saktë.

Vlerësimi i aplikimeve:

Divizioni për arsimin privat parauniversitar pranë MASH-it do të shqyrtojë aplikimet e dorëzuara dhe do të verifikojë përmbushjen e kritereve për pjesëmarrje në Programin e Kuponëve. Shqyrtimi do të përfshijë verifikimin e licencimit të institucionit dhe të të dhënave të deklaruara gjatë aplikimit.

Pas përfundimit të verifikimit, institucionet që përmbushin kriteret do të evidentohen si institucione pjesëmarrëse në program. Vendet e lira të deklaruara nga këto institucione do të shërbejnë për procesin pasues të aplikimit dhe përzgjedhjes së fëmijëve përfitues.

Institucionet që tashmë janë pjesë e programit:

IEFH-të që tashmë janë pjesë e Programit të Kuponëve duhet të aplikojnë gjithashtu në këtë thirrje për të përditësuar të dhënat e tyre dhe për të deklaruar vendet shtesë të lira që mund të ofrojnë për fëmijë të rinj përfitues.

Në deklarimin e vendeve të lira, institucionet duhet të përfshijnë vetëm kapacitetet shtesë, përtej vendeve të zëna nga fëmijët që aktualisht përfitojnë nga programi.

Informata shtesë:

Për sqarime lidhur me kriteret e pjesëmarrjes, plotësimin e formularit dhe procedurën e aplikimit, institucionet mund të kontaktojnë ekipin e Programit të Kuponëve:

- Telefon: 038 200 65048
- E-mail: programiikuponave@rks-gov.net